SHABAN ÇUPI

KUSH E THEMELOI HANIN E ELEZIT

2025

Treva e Hanit të Elezit është një mikroregjion i caktuar shqiptar dhe shtrihet në pjesën jugore të Kosovës së sotme dhe kufizohet me Republikën e Maqedonisë Veriore. Në regjistrimin e fundit (2024) ka të evidentuar 8600 banorë dhe ka një sipërfaqe prej 83 $km^{2.}$

Si pjesë e etnikumit shqiptar, gjithmonë ka gravituar ndërmjet Skupit dardan në jug dhe Kaçanikut në veri. Të gjitha fshatrat për rreth, janë evidentuar edhe në regjistrimet osmane me numër të konsiderueshëm shtëpish, ndërsa fushgropa e Hanit të Elezit të sotëm jo çdo herë ka qenë e banuar.

Nga një gojëdhënë e lashtë, thuhet se dikur edhe në këtë fushëgropë ka pasur vendbanim, por që e kanë përmbytur ujërat për rreth. Këtë gojëdhënë apo hipotezë të ngritur e vërtetojnë ose e bëjnë argument shkencor, artefaktet e gjetura të cilat i përkasin shekullit II të erës sonë, duke konstatuar se kjo trevë ka qenë e banueshme në vazhdimësi mbi 1800 vite.

Ne nuk dimë se si është quajtur kjo trevë në kohën romake e bizantine, por nga shekulli

XVI, në harta evidentohet si SAR, ndërsa më vonë, në shekullin XIX-të, gjithsesi në kohën e Perandorisë Osmane, kur Elezi ngriti Hanin, filloi të quhet Elez Han dhe pikërisht ky emërtim është edhe pjesë e hulumtimit tonë.

Se prej nga ishte Elezi si themelues i Hanit, ka pasur mendime të ndryshme, por jo të mbështetura në argumente shkencore. Duke i pasur parasyshë të gjithë këto, ka vite që jemi marrur me gjenezën e Hanit dhe pronarit të tij dhe në fund kemi konstatur se Elezi ishte nga fshati Dimcë i Hanit të Elezit të sotëm dhe ky konstatim është argumentues.

Krahas burimeve familjare, si dhe trungjeve të vijës gjenealogjike të familjes, duke mos lënë anash as memorien popullore, ne kemi shfrytëzuar edhe referenca të autorëve të ndryshëm, të gjeografëve dhe historianëve që rreth kësaj treve kanë dhënë mendime me vlerë. Të gjitha këto referenca, natyrisht që ne i kemi konsultuar, i kemi karahasuar dhe i kemi shfrytëzuar, duke filluar nga ato më të vjetrat, si nga Jovan Cvijiqi pastaj

Engjëll Gjini dhe Mr. Tefik Raka. Tejet domethënëse kanë qenë edhe hulumtimi i hartave austro-hungareze si dhe udhëpër-shkruesve të ndryshëm që kanë shkruar për këtë trevë dhe që natyrisht kanë ndihmuar në zbardhjen e kësaj teme e cila për trevën e Hanit të Elezit ka një rëndësi të madhe, gjithnjë duke i lënë hapësirë edhe zbulimeve të reja të mundëshme arkivore.

Elezi dhe Hani i tij



Si edhe më parë, edhe në këtë kohë (shekulli XIX), komunikacioni transportues i mallrave bëhej me karavane kuaj e qerre, ngase nëpër Grykën e Kaçanikut, udhëtimi natën ka qenë i vështirë dhe i pasigurt, karavanet e qerreve dhe udhëtarët, ndaleshin pa hyrë në grykë për të kaluar natën. Meqë ishte nevojë dhe imperativ i kohës, sipas të dhënave gojore dhe atyre të shkruara historike, në gjysmën e parë të shekullit XIX, në këtë vendbanim ndërtohet një han (ekziston edhe sot). Hanin, që sipas disa të dhënave ka qenë godina e parë e ndërtuar në këtë vend, e ndërtoi një fshatar i quajtur Elez nga fshati Dimcë (2 - 3 km, në lindje të Hanit të Elezit - T.R.). Sipas pronarit të hanit, Elezit, edhe vendbanimi, përkatësisht vendi filloi të quhet Hani i Elezit (Elez-Hani). Këtë emër, që doli nga vetë popullata e kësaj ane, ky vendbanim e mbajti deri më 1912. Atëherë,

Faksimil nga shkrimi i Mr. Tefik Raka në gazetën ,,Bujku'' Prishtinë, i datës 10 janar 1996

Mr. Tefik Raka, tanimë dëshmorë i luftës së vitit 1999, historian nga Kaçaniku, nga hulumtimet që i ka bërë ai, konstaton se Hanin e ka themeluar Elezi nga fshati Dimcë i po kësaj qyteze si dhe përcaktoi kohën e emërtimit të tij,, *Në gjysmën e parë të shekullit XIX".* Të njejtin mendim për Elez Dimcën e ka edhe Engjëll Gjini në shkrimin e tij në revistën *Përparimi* - Prishtinë i vitit 1968 nr. 11-12 i cili i referohet hulumtimeve të Jovan Cvijiqit në vitin 1914.

Trungu familjar i Elez Dimcës

Duke hulumtuar në trungun e Elez Dimcës (Micit) nga Hani i Elezit, gjetëm se Shaban Mici ka lindur në vitin 1928 dhe vdekur në vitin 2002. Shabani ishte i Nezirit i lindur në vitin 1882 gjithnjë bazuar në librin e të lindurve. Neziri ishte i Arifit dhe duke diferencuar brezin nga brezi me 30 vite, konstatuam se Arifi ka lindur në vitin 1852. Nga Arifi duke zbritur brezin me 30, rezultoi se Elez Dimca ka lindur në vitin 1822. Pra në vijën gjenealogjike të trungut,

ekziston Elezi dhe kjo saktësohet nga shumë burime. Në anën tjetër viti i përafërt se kur ka jetuar Elez Dimca i përgjigjet kohës që ka shkruar Mr. Tefik Raka, ***gjysma e parë e shekullit XIX e që i bie rreth vitit 1850.***
Duke kërkuar fakte e argumente të tjera rreth këtij konstatimi, rrjedha e hulum-timeve të mëtejme, na solli edhe tek një Elez tjetër, tek Elez Duhani nga Begraca e Kaçanikut dhe Bajram Daci nga Puset e Nikës. Rrjedha e hulumtimit na e vërtetoi se që të tre kanë ushtruar këtë veprimtari. Më saktë kishin hane, e që hani në varësi të natyrës së punës quhej edhe tabakhane, ndërsa më vonë edhe bakallhane. Si objekte të gjitha janë tregtare, por nga përmbajtja e punës nuk kanë qenë të gjitha të njejta.

Trungu familjar i Elez Duhanit

Në trungun e Elez Duhanit nga Begraca e Kaçanikut gjetëm këto të dhëna;
Kemal Abdi (Duhani) është i lindur në Shkup në vitin 1964 dhe autori i këtij shkrimi ka zhvilluar bisedë me atë, më 20 qershor 2020. ai tha se: Kemali është

Zekirijasë, Zekirijau i Kemalit, Kemali është i Elezit. Elezi është i lindur në vitin 1870 ose 1880, ndërsa ka vdekur në Shkup në vitin 1943 , në ditën kur evrejtë janë transportuar nga Shkupi prej gjermanëve dhe është varrosur në varrezat e Gazibabës në Shkup, ndërsa Elezi ishte i Abdi Duhanit nga Begraca e Kaçanikut. Pra, edhe në këtë trung saktësohet ekzistimi i Elezit dhe dihet koha e vdekjes së tij.

Është vërtetuar se Elez Duhani nga Begraca e Kaçanikut ishte një tregtar që merrej me tregti të ndryshme dhe është saktësuar se në Han të Elezit ka pasur një Tabakhane.

Nga dëshmitë e mbledhura na bëhet e ditur se në Serbi të Parë (tetor 1912-1915) Fezë Thaçi nga Kryeniku bashkë me Nurë Dibranin nga fshati Seçishtë, shkojnë në Tabakhanen e Elez Duhanit për të blerë duhan, por vriten nga serbët dhe varrosen në varrezat e fshatit Seçishtë. Se Tabakhanen, Elez Duhani e ka pasur edhe në kohën e Perandorisë Osmane, dëshmohet se pas LDB-së, pushteti komunist jugosllav ka malltretuar djemt e Elez Duhanit duke

kërkuar lirat e babait të tyre. Familja e Elez Duhanit në Shkup, nga pushteti komunist jugosllavë trajtohej si familje ,,kulake'' dhe nga presioni, vëllau i Kemajlit, Abdiu shpërngulet në Turqi ku edhe atje vdes, ndërsa Kemajli ndërron mbiemrin në Abdiu. Duke i krahasur dy Elezat, konstatojmë se Elez Duhani ka pasur Hanin e tij përkatësisht Tabakhanen, por në kohë të më vonëshme dhe këtë do ta vërejmë edhe nga hartat e gjetura që do t`i shpalosim më poshtë.

Personi tjetër që vërtetohet se ka pasur Han, është Bajram Daci, në popull i njohur si Hani i Bajram Dacit nga Puset e Nikës. Në zhargonin popullor, më të vjetrit shpreheshin se në këtë dhomë ***koka ftoft si në Hanin e Bajram Dacit***. Kjo shprehje, edhepse popullore, vërteton ekzistimin e hanit. Vendi i këtij hani ishte në afërsi ku sot është furra e bukës *Drini i Bardhë* por edhe pronat ku ishte hani, janë prona të familjes Daci. Në anën tjetër, Bajram Daci së bashku me Imer Dacin njiheshin edhe si tregtarë të mëdhenjë, andaj edhe hani ishte një objekt i

nevojshëm si bujtinë, por edhe si objekt tregëtie e mbi të gjitha i duhanit i cili transportohej për Selanik. Se a është e mundur që Elez Dimca të ketë bashkë-punuar me Bajram Dacin brenda një hani, ne këtë nuk mund ta vërtetojmë, por që hani ishte i Elezit si pronar që nga fillet e tij, kjo tanimë vërtetohet nga vetë emërtimi.

Hartat hekurudhore austro-hungareze si argumente shkencore

Në vitin 2020 duke hulumtuar hartat hekurudhore austro-hungareze gjetëm se Theodor von Bomsdorf në vitin 1875, e evidenton në hartë Hanin e Elezit në formën Elez Han, Ky evidentim bëhet një vit pasiqë inaugurohet hekurudha. Pra, Bomsdorf e konkretizon se Hani ishte i Elezit dhe ky fakt spastron idetë tjera. Në rrjedh të hulumtimeve, në vitin 2024, prof. Naim Vlashi, gjeograf nga Hani i Elezit, gjeti të dhëna po nga hartat hekurudhore, se albanologu gjerman Johann Georg Hahni, Hanin e Elezit e evidenton në hartë në vitin 1867, duke u mbështetur në hulumtimet që ka bërë nga lumi Drin deri në Vardar në

vitin 1858.
Pra, kjo e dhënë tjetër faktike e albanologut gjerman Johan Hahn, sqaron se gjatë hulumtimeve të tij ka ekzistuar hani dhe ai ishte i Elezit, pra nënkuptohet i Elez Dimcës, sepse Elez Duhani me prejardhje nga Begraca e Kaçanikut as që ka qenë i lindur në atë kohë.
Nga këto të dhëna, konstatojmë se teza e Mr. Tefik Raka se Hanin e ka themeluar Elez Dimca u përgjigjet këtyre të dhënave.
Në anën tjetër, etnografi gjerman Ami Boue (1794-1881) duke kaluar nëpër vendet e Ballkanit, kalon edhe nëpër Kaçanik në drejtim të Shkupit. Ai përmend se ka pirë ujë te Uji i Thartë, por nuk e përmend Hanin askund. Gjithë këtë udhëpërshkrim Ami Boue e boton në librin e tij në vitin 1840. Nga këto të dhëna kuptojmë se në vitin 1840, Hani nuk ka ekzistuar dhe atë duhet kërkuar në mes të viteve 1840– 1858.



Hartë e vitit 1875 e autorit austriak Theodor Bamsdorf ku Hani i Elezit evidentohet një vit pasi hapet hekurudha Selanik—Mitrovicë, në formën Elez Han

Hartë e vitit 1867 nga albanologu gjerman Johann Georg Hann ku evidentohet Hani i Eleziti, në formën Eles H



Johann Georg Hahn për kontributin që ka dhënë në albanalogjinë shqiptare, njihet edhe si themeluesi i albanalogjisë. Ai ka shërbyer edhe si diplomat austriak.
Ka botuar librin ,,Studime albanologjike"



Po si quhej treva e Hanit të Elezit para se të ngritej hani ?

Treva e Hanit të Elezit, se është një trevë e Dardanisë e rrjedhimisht e Ilirisë, dëshmohet nga artefaktet e gjetura nëpër vite, qoftë në fshatin Dimcë, Kryenik, Han të Elezit e Paldenicë. Dy kalatë ekzistuese, por

të pahulumtuara si dhe relikte të ndryshme si gjetje rasti e mbi të gjitha spiralja koncentrike si dhe mikrotoponimet e antroponimet, dëshmojnë vijën e lashtë ilirodardano-shqiptare në këtë trevë.

Në rrjedhë të këtij hulumtimi, sërish jemi konsultuar me hulumtimet shkencore të Mr. Tefik Raka (historian) nga Kaçaniku i cili po në shkrimin e botuar në ,,Bujku'' të datës 10 janar 1996, shkruan se:

Nuk ka të dhëna të shkruara se çfarë emërtimi ka pasur ky vendbanim në kohën e sundimit romak. Emërtimi i parë i këtij vendbanimi daton nga shekulli XVI. Të dhënat e shkruara historike dëshmojnë se në rrëzën e malit Sharr, në hartat e vjetra, deri vonë figuron vendbanimi me emërtimin SAR (SHARR) i cili ka të bëj me Hanin e Elezit të sotëm, për çka ka edhe dëshmi të tjera historike, shkruan Mr. Tefik Raka.

Në vazhdim, ai thotë se *Sar (Sharr) si vendbanim përmendet në shekullin XVI , përkatësisht në vitet 1546, 1595, 1684, 1689, 1730, 1775, 1788, 1812, 1822. Mirëpo, më vonë ky vendbanim nuk përmendet më me emërtimin Sar (Sharr) po me një emër tjetër– Hani i Elezit*(Elez Han plotësim. Sh.Ç)



Prania e popullatës dardane

Gryka e Kaçanikut, si në të hyrë, ashtu edhe në të dalë prej saj, ka qenë e banuar qysh në kohën e studimit romak. Në depresionin e Hanit të Elezit të sotëm, vendbanimet ilire kanë qenë të ndërtuara në afërsi të grykës, aty ku kanë shpënë edhe rrugët e lashta, të cilat lidhnin Kosovën me Shkupin. Praninë e vendbanimit iliro-dardan në trevën e Hanit të Elezit e bëjnë të qartë dhe bindëse materialet e gjetura arkeologjike të kohës antike. Përveç gërmadhave të një "castela" (kështjelle-fortifikate), në këtë trevë janë zbuluar edhe materiale të rëndësishme kulturore arkeologjike, që flasin për praninë e popullatës dardane, përkatësisht ilire në këtë anë.

Nuk ka të dhëna të shkruara se çfarë emërtimi ka pasur ky vendbanim në kohën e sundimit romak. Emërtimi i parë i këtij vendbanimi daton nga shekulli XVI. Të dhënat e shkruara historike dëshmojnë se, "në rrëzën e malit Sharr, në hartat e vjetra, deri vonë figuron vendbanimi me emërtimin SAR (SHARR), i cili ka të bëjë me Hanin e Elezit të sotëm, për çka ka edhe dëshmi të tjera historike".

Sipas tabelës së paraqitur, ku janë regjistruar emërtimesh që kanë të bëjnë me malin Sharr, pastaj Glubotina (fjala është për Lubotenin), Sar (Sharr) si vendbanim përmendet në shekullin XVI, përkatësisht në vitet. 1546, 1589, 1595, 1684, 1689, 1690, 1730, 1775, 1788, 1812, 1822. Mirëpo, më vonë ky vendbanim nuk përmendet më me emërtimin Sar (Sharr), po me një emërtim tjetër - Hani i Elezit.

Si edhe më parë, edhe në këtë kohë (shekulli XIX), komunikacioni

Faksimil nga shkrimi i Mr. Tefik Raka, botuar në gazetën ditore ,,Bujku" të 10 janarit 1996, Prishtinë